



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 korrik 2015
Nr. ref.: RK 811/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI20/15

Parashtrues

Organizata joqeveritare FINCA Kosovë

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Rev. nr. 205/2014, të 14 tetorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është organizata joqeveritare FINCA Kosovë, të cilën e përfaqëson z. Vigan Rogova, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 205/2014, të 14 tetorit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin e ka pranuar më 9 dhjetor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar Rev. nr. 205/2014, të 14 tetorit 2014, përkitazi me pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, përkitazi me pezullimin e procedurave përmbarimore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22, 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 shkurt 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 10 prill 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 12 prill 2015, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI20/15, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI20/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).
9. Më 1 korrik 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI20/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit i ka përfunduar mandati i gjyqtarit më 26 qershor 2015 dhe, me Vendimin KSH. KI20/15, Kryetarja, zëvendësoi gjyqtarin Ivan Čukalović në përbërjen e Kolegjit shqyrtues.
10. Më 6 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 25 shtator 2000, parashtruesi lidhi kontratë pune me të punësuarën Sh. K. përkitazi me postin e punës analist i kredive.
12. Më 21 mars 2011, parashtruesi vendosi të punësuarës t'ia ndërpresë kontratën e punës, për shkak të vonesave të kthimit të kredive.
13. Më 18 maj 2011, e punësuarë, kundër vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës ushtroi padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit, duke kërkuar anulimin e vendimit, si të paligjshëm, dhe kthimin e saj në vendin e punës.
14. Më 13 shtator 2012, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 290/11) përkitazi me padinë e të punësuarës, vendosi si më poshtë: I. Aprovoi pjesërisht padinë e të punësuarës; II. Anuloi, si të paligjshëm vendimin e parashtruesit të 21 marsit 2011, përkitazi me ndërprerjen e kontratës së punës së të punësuarës; III. Detyroi parashtruesin që t'ia paguajë paditëses 14 (katërmëdhjetë) paga të papaguara, në shumë mujore prej 1,000.00 € dhe në shumë të përgjithshme prej 14,000.00 €; IV. Detyroi parashtruesin që t'ia paguajë paditëses shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumë prej 606.00 €; dhe V. Refuzoi kërkesëpadinë e të punësuarës për kthim në vendin e punës.
15. E punësuarë, kundër këtij aktgjykimi, kishte ushtruar të drejtën e ankesës në gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), përkitazi me pikën III dhe V të dispozitivit të Aktgjykimit.
16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit në afatin ligjor, ankesë kishte ushtruar edhe parashtruesi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.
17. Më 7 prill 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi, Ac. nr. 4342/2012), refuzoi, si të pabazuara, ankesat e ushtruara nga e punësuarë si dhe nga parashtruesi, duke vërtetuar kështu Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit.
18. Parashtruesi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme, me propozimin që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të priset, dhe çështja të kthehet në rigjykim.
19. Po ashtu, edhe e punësuarë, kishte ushtruar kërkesë për revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, duke kërkuar ndryshimin e pikës III dhe V të Aktgjykimit, përkitazi me kompensimin e të gjitha pagave të papaguara dhe kthimin e saj në vendin e punës.
20. Më 14 tetor 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 205/2014 dhe vendosi: të refuzojë revizionin e ushtruar nga parashtruesi në pikën I dhe II të aktgjykimit; të aprovojë revizionin e parashtruesit në pikën III të aktgjykimit përkitazi me kompensimin e pagave të papaguara; të prishë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në pikën IV të dispozitivit dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së instancës së parë për rishqyrtim dhe rigjykim për këtë pikë; të

aprovojë revizionin e të punësuarës përkitazi me pikën V të dispozitivit të aktgjykimit për kërkesën për kthim në vendin e punës.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, shkeli të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, për shkak se “... Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. Nr. 205/2014 të datës 9 Dhjetor 2014 e ka privuar parashtruesin e kërkesës nga të drejtat e tij Kushtetuese që rrjedhin nga neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit”.
22. Parashtruesi gjithashtu i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KO131/12.
23. Parashtruesi pretendon se “Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e vendosjes për kthim në vendin e punës të paditëses është marr në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit të Punës, e që ka të bëjë me Vendosjen gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës”.
24. Për më tepër parashtruesi nga Gjykata kërkon: “Të shpall kërkesën të pranueshme; Të konstatoj që ka pasur shkelje të nenit 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 205/2014 datë 14 Tetor 2014; Të kthejë këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate; Të merr masën e përkohshme për pezullimin e të gjitha veprimeve përmbaramore dhe procedurave”.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata Kushtetuese, para se ta shqyrtojë kërkesën e parashtruar, duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruesit i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Për këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.
27. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) (d) i Rregullores së punës parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.*
28. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullores së punës parasheh:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

29. Gjykata, në këtë rast, vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj Rev. nr. 205/2014, ka shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aluduar se kthimi i paditëses në vendin e punës dhe kompensimi i saj ishte në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura, si dhe në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit të punës (Nr. 03/L-212) të Republikës së Kosovës.
30. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata, konsideron se një pretendim i tillë nga ana e parashtruesit, nuk paraqet bazë kushtetuese të argumentuar dhe të arsyetuar, që kushtimisht do t'i lejonte Gjykatës që të lëshohej më tutje në vlerësimin e meritave të kërkesës. Parashtruesi nuk ka qartësuar, si dhe pse, Gjykata Supreme mori vendim, duke shkelur të drejtat e parashtruesit të garantuara me dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës, dhe të KEDNJ-së.
31. Gjykata thekson se, për të pasur një rast të argumentueshëm, që ngre shkelje kushtetuese, parashtruesi duhet të dëshmojë dhe provojë se procedurat në gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me kërkesat e një gjykimi të drejtë, apo që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, gjatë procesit të gjykimit.
32. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të parashtruesit përkitazi me shkeljen e dispozitave të ligjit material, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë i përket fushës së ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë.
33. Gjykata, kujton se nuk është detyrë e saj të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, siç është në rastin konkret interpretimi i ligjit, nëse urdhri për kompensim ose kthimin e paditëses në punë ishte i bazuar në ligj. Marrëdhëniet kontraktuale dhe ato të punës janë të rregulluara me ligj, dhe interpretimi i dispozitave të këtyre ligjeve është edhe juridiksion i gjykatave të rregullta, posaçërisht i Gjykatës Supreme si instancë më e lartë e gjyqësorit të rregullt.
34. Në këtë kontekst, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz vs. Spain* [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
35. Gjykata konsideron se arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme është i gjerë, gjithëpërfshirës dhe përmban arsyetim të detajuar se përse është dashur që

aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, të vërtetohen, të prishen apo të ndryshohen në disa pika të dispozitivit të aktgjykimeve.

36. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur një gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
37. Prandaj, Gjykata në rastin konkret, nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

38. Parashtruesi, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë Masë të përkohshme, gjegjësisht të pezullojë të gjitha veprimet dhe procedurat e përmbarimit lidhur me çështjen e tij.
39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës”.
[...]
40. Gjykata më tutje konstaton se, pasi që kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe shpallet e papranueshme, kërkesa për Masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit para Gjykatës, prandaj kërkesa për vendosjen e Masës së përkohshme duhet të refuzohet.
41. Nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar dhe duhet shpallur si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) (d), 36 (2) (d), 54, 55 dhe 56 (2, 3) të Rregullores së punës, më 31 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

